



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2022-2024 dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR ÇAKTIMIN E KORDINATORIT TË KOMITETIT KOMUNAL VEPRUES

**Neni 1**

Me këtë Vendim nëpunësi civil, Behar Aliu në Drejtoratin për Administratë **ÇAKTOHET** Kordinator i komitetit veprues komunal në Komunën e Lipjanit .

**Neni 2**

Kordinatori i Komitetit Komunal Veprues do t'i kryej këto detyra në bazë të Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2022-2024.

- 1.Të organizojë takimet e KKV-së;
- 2.Të përgatisë të gjitha materialet e nevojshme për takimet e KKV-së ;
- 3.Të përpilojë procesverbale për secilin takim të KKV-së;
- 4.Të Përpilojë raportet gjashtëmujore dhe vjetore ,për punën e KKV-së;
- 5.Në bashkëpunim me anëtarët e KKV-së,të përpilojë raportet gjashtëmujore dhe vjetore të monitorimit për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2022-2024 ,në nivel lokal;
- 6.Të dërgojë raporte të hartuara tek Zyra e Kryeministrit /Zyra për Qeverisje të Mirë ,sipas formatit të paracaktuar nga kjo zyrë;
- 7.Të ndihmojë komunikimin e anëtarëve të komitetit me autoritetet qendrore ,përkatësisht Zyren e Kryeministrit /Zyren për Qeverisje të Mirë,si dhe Institucioneve tjera relevante.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryetari i Komitetit Komunal Veprues Diamant Bytyqi dhe Kordinatori i komitetit Komunal Veprues Behar Aliu.

INr.020/04-8874  
Lipjan, më 16.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

### V E N D I M

## PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATES TË OJQ-SË PËRFITUESE PËR AKTIVITETEVE ME RASTIN E 15 VJETORIT TË PAVARSISË SË KOSOVËS

### Neni 1

Me këtë Vendim, **Mergim Oruçi**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontrates të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe OJQ-së "Alternativa Rinore për Progres" e lidhur për realizimin e projektit "Aktivitete me rastin e 15 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës" për vitin 2023.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontrates të OJQ-së si vijon :

Nr.	Emërtimi i OJQ-së
1.	OJQ "Alternativa Rinore për Progres"

### Neni 2

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontrates të lidhur mes Komunës dhe OJQ-së të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Mergim Oruçi dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 453/01-8626  
Lipjan, më 15.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 15 të Ligjit Nr.08/L-114 për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave si dhe nenit 3 të Rregullores për funksionimin e Komisionit Komunal të Regjistrimit të datës 06.01.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË REGJISTRIMIT (KKR)**

**Neni 1  
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni Komunal për Regjistrim në Komunën e Lipjant (KKR), në përbërje si vijon:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit, Kryesues
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës së Lipjanit, Zëvendes kryesues,
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës së Lipjanit për Komunitete, anëtar,
4. \_\_\_\_\_, Agjencia e Statistikave të Kosovës, anëtar,
5. Majlinda Krasniqi, Shoqëria Civile, anëtare,
6. Rasim Hasani, Drejtor në Drejtoratin për Arsim, anëtar,
7. Imri Semetishti, Drejtor në Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar,
8. Safete Amerllahu, Drejtoresh në Drejtoratin për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtare dhe
9. Behar Aliu, Zyrtar në Drejtoratin për Administratë, anëtar.

**Neni 2  
Detyrat e KKR**

Komisioni Komunal për Regjistrim në Komunën e Lipjanit (KKR), do të kryej detyrat në bazë të Ligjit Nr.08/L-114 për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave si dhe Rregullores për funksionimin e Komisionit Komunal të Regjistrimit të datës 06.01.2023 si dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

**Neni 3  
Mandati**

Mandati i Komisioni Komunal për Regjistrim në Komunën e Lipjant (KKR) përfundon me publikimin e të dhënave paraprake.

**Neni 4  
Hryja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Agjencia e Statistikave të Kosovës, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-5784  
Lipjan, më 01.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 si dhe bazur në kërkesën 1Nr.020/01-8099 të datës 14.02.2023 nga Drejtorati për Arsim, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT**  
**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË TË**  
**KOMUNËS SË LIPJANIT 15Nr.670/01-21260 TË DATËS 26.04.2022**

**Neni 1**  
**Përbërja**

Formohet Komisioni për hartimin e Projekt- Rregullores për ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, në këtë përbërje:

1. Ismet Haziri, Zyrtar ligjor në Drejtoratin për Arsim, Kryesues
2. Valdete Muji, Zyrtare ligjore në Sektorin për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtare
3. Islam Kaleshi, Zyrtar ligjor në Sektorin për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, anëtar.

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni ka për detyrë dhe përgjegjësi të hartoj Projekt- Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Lipjanit 15Nr.670/01-21260 të datës 26.04.2022, konform dispozitave përkatëse ligjore në fuqi më së largu deri me 15.03.2023.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëtin do të njoftohen Drejtorati për Arsim, kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/01-8099  
Lipjan, më 14.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF -NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore, kulturore dhe rekreative në rastin e 15 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës sipas thirrjes publike Nr.1-453/01-975 të datës 06.01.2023, në përbërje si vijon:

1. Agim Bylkbashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Fadil Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Majlinda Krasniqi nga OJQ-të, anëtare
5. Shkëlqim Bahtiri, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit, anëtar
6. Teuta Berisha, Drejtorati për Arsim, anëtare rezerv

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve organizimin e aktiviteteve të ndryshme rinore, kulturore dhe rekreative në rastin e 15 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës kanë aplikuar konform Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453/01-975 të datës 06.01.2023, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**  
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-5846  
Lipjan, më 02.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Me këtë Vendim, formohet Komisioni i përkohshëm ad.hoc për evidentimin dhe regjistrimin e gjendjes aktuale të aseteve të cilat kanë qenë në shfrytëzim paraprak nga ana e KRM "Pastrimi" sipas kontratës me titull "Mirëmbajtja e tregjeve në Komunën e Lipjanit" e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit si autoritet kontraktues dhe KRM "Pastrimi" SH.A si ofrues i shërbimeve e cila kontratë është para përfundimit .

II.Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Bedri Hetemi , Drejtorati për Inspeksion, Kryesues
2. Enis Gashi, Drejtorati për Inspeksion, anëtar
3. Muhedin Krasniqi, KRM "Pastrimi, anëtar

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni kam për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë evidentimin dhe regjistrimin e gjendjes aktuale të aseteve të cilat kanë qenë në shfrytëzim paraprak nga ana e KRM "Pastrimi" sipas kontratës me titull "Mirëmbajtja e tregjeve në Komunën e Lipjanit" e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit si autoritet kontraktues dhe KRM "Pastrimi" SH.A si ofrues i shërbimeve e cila kontratë është para përfundimit.

Komisioni detyrat e cekura do ti kryej më së largu me datë 23.02.2023 dhe lidhur me këtë duhet të hartoj raport me shkrim me të cilin duhet ta njoftoj Kryetarin e Komunës, Drejtoratin për Prokurim dhe Menaxherin e Kontratës .

IV. Komisioni ka mandat të përkohshëm dhe me përfundimin e detyrave të cekura pushon edhe mandati i tij.

V. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi me anëtarët e Komisionit, Drejtori i Drejtoratit për Prokurim dhe Menaxheri i Kontratës Enver Elshani.

VI. Vendimi hyn në fuqi menjëherë .

1Nr. 020/01-9688  
Lipjan, më 22.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400-15449 të datës 17.03.2021 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr:

## VENDIM

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

#### Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,140.00€**, (shtatë mijë e njëqind e katërdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-5790 të datës 01.02.2023, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 34 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin janar të vitit 2023 me nga 210 euro për secilin rast  $34 \times 210 = 7,140.00€$ , të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan 01-400-01-19079 e datës 13.04.2021.

#### Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatriut të Komunës në xhiorrolloarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

#### Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-5790  
Lipjan, më 02.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të për projektin “Aktivitete me rastin e 15 vjetorit të Pavarsisë së Kosovës” Nr.5-453/01-6679 të datës 06.02.2023, si dhe Rekomandimit të komisionit vlerësues Nr.1-400/01-8411 të datës 14.02.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR AKTIVITETET ME RASTIN E 15**  
**VJETORIT TË PAVARSISË SË KOSOVËS**

**Neni 1**

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **9,990.00 €** (nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-në “Alternativa Rinore për Progres” për realizimin e aktiviteteve për projektin “Aktivitete me rastin e 15 vjetorit të Pavarsisë së Kosovës” sipas Projekt- Propozimit të paraqitur sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.1-453/01-975 e datës 06.01.2023.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për projektin “Aktivitete me rastin e 15 vjetorit të Pavarsisë së Kosovës”

Nr.	Emërtimi i OJQ-së	Shuma
1.	OJQ “Alternativa Rinore për Progres”	9,990.00 €
	Shuma Totale	<b>9,990.00 €</b>

**Neni 2**

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 3**

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen me Kontratë të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.400/01-8411  
Lipjan, më 14.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti







REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**VENDIM**  
**PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIFIKIMIT TË**  
**PROJEKT BUXHETIT 2024-2026**

**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024-2026, në përbërje si vijon:

1. Latif Ramadani, Drejtor në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Visar Kozhani, Zyrtar në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtar,
3. Alban Bytyqi, Zyrtar financiar në QKMF, anëtar,
4. Ismet Haziri, Zyrtar në Drejtoratin për Arsim, anëtar dhe
5. Ferdian Shala, Zyrtar në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtar.

**Neni 2**  
**Detyrat e grupit punues**

Grupi punues ka për detyrë hartimin e projekt planifikimit të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024-2026 si dhe organizimin e degjimeve buxhetore në Komunën e Lipjanit. Grupi punues duhet të hartojë planin e punës dhe të caktoj orarin e mbajtjes së degjimeve buxhetore duke mbajtur procesverbal dhe duke hartuar raport të punës së kryer të gjitha detyrat e hartimit të planifikimit të buxhetit për vitin 2024-2026 dhe organizimin e degjimeve buxhetore do të bëjë konform dispozitave të parapara ligjore që janë në fuqi. Po ashtu në fund të hartojë raportin nga degjimet buxhetore për ta dërguar në Kuvendin e Komunës.

**Neni 3**  
**Hryja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-6549  
Lipjan, më 06.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 , Strategjisë për Avancimin e të drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planit të Veprimit 2022-2024 si dhe neneve 9, 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 duke u bazuar edhe në Shkresën e MAPL-së Nr 0-43 të datës 16.01.2023 , Kryetari i Komunës merr

VENDIM  
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT KOMUNAL VEPRUES  
NË KOMUNËN E LIPJANIT


**Neni 1**  
**Përbërja**

Me këtë Vendim themelohet Komiteti komunal veprues në Komunën e Lipjanit në përbërje si vijon:

1. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës, Kryesues
2. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar
3. Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
4. Albert Mustafa , Shef i Sektorit DSHPS dhe zyrtar përgjegjës nga fusha e banimit, anëtar
5. Lidija Jovanovic, Zyra Lokale për Komunitete
6. Fjolla Ibrahimimi , QPS dhe Zyrtare për mbrojtjen e fëmijës
7. Hasan Luma , Zyrtar për barazi gjinore
8. Shahadije Ibrahimimi, Shefe e Sektorit për Buxhet dhe Financa
9. Sunaj Garip –OJQ, “All Youth Together, anëtar
10. Adelina Qorraj Emini – OJQ- “Women`Alliance for Integration”, anëtare
11. Majlinda Krasniqi OJQ “The Ideas Partnership”, anëtare
12. Shkelqim Bahtiri OJQ “Ipko foundation”, anëtar

**Neni 2**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit komunal veprues**

1.Komiteti komunal veprues kryen detyrat dhe përgjegjësitë konform Strategjisë për Avancimin e të drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E KRYESUESIT TË KOMISIONIT 1NR.020/01-9688 TË DATËS  
22.02.2023

I. Me këtë Vendim, zëvendësohet, Kryesuesi i Komisionit 1Nr.020/01-9688 të datës 22.02.2023 për evidentimin dhe regjistrimin e gjendjes aktuale të aseteve të cilët kanë qenë në shfrytëzim paraprak nga ana e KRM "Pastrimi" sipas kontrates së për mirëmbajtjen e tregjeve në Komunën e Lipjanit, dhe në vend të tij caktohet:

**RAFETE RETKOCERI**, Zyrtare në Drejtoratin për Shërbime publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

Rafete Retkoceri, Kryesuesi e Komisionit  
Drejtori, i Drejtoratit për Prokurim  
Enver Elshani, Menaxher i Kontratës

1Nr.020/01-9688/2  
Lipjan, 23.02.2023

KRYETARI I KOMUNËS  
Imri Ahmeti

